

LIGJ
Nr. 105/2017

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri apo institucioni që ka në fushën e përgjegjësisë regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët kushtet, procedurat dhe metodologjinë për zbatimin e këtij neni.”.

Neni 2

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Pas shkronjës “F” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”. Përfshirja nga tatimi mbi fitimin, i parashikuar sipas këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024. Efektet e përfshirjes fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.”.

2. Në paragrafin e fundit, fjalët “deri në shkronjën “F”,” zëvendësohen me fjalët “deri në shkronjën “g”,”.

Neni 3

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Shkalla tatimore

1. Tatimi mbi fitimin është 15%.

2. Për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetet për prodhimin/zhvillimin e *software*-ve, tatimi mbi fitimin është 5%. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të *software*-ve, si dhe procedurat për zbatimin e këtij paragrafi.”.

Neni 4

Në nenin 38, pika 7, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat e organizatorëve të lojërave të fatit tatohen me tarifën tatimore mbi të ardhurat bruto, sipas kuptimit dhe përcaktimit në ligjet respektive të fushës, ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project”, sh.p.k.””.

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Miratuar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10686, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta